


Sonja Kirkovska  
Nela Slezenkova-Nikovska

# SHKENCAT NATYRORE

## PËR KLASËN E DYTË

Viti shkollor 2022/2023



# Shkencat natyrore për klasën e dytë

Viti shkollor 2022/2023

## Autorë

Sonja Kirkovska  
Nela Slezenkova-Nikovska

## Recensentë

Jasmina Najdovska  
Daniela Apostolovska  
Vera Dimova

## Ilustrimet:

Anastasia Dimitrova

## Botues:

Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, 1000 Shkup

## Titulli i origjinal:

Природни науки за второ одделение  
Соња Кирковска  
Нела Слезенкова-Никовска

**Përkthyer nga gjuha maqedonase:** Neshe Salih

**Lektor:** Jehona Ejupi

**Redaktor profesional i botimit në gjuhën shqipe:** Neshe Salih

**Redaktor:** Neshe Salih

**Redaktimi grafik dhe teknik:** Magdalena Avramovska, Evgenija Pavlova - ARS STUDIO

**Shtypi:** Evropa 92 – Koçan

**Tirazhi:** 6838

**Vendi dhe viti i botimit:** Shkup, 2022

Me vendim për miratimin e tekstit mësimor në lëndën e shkencave të natyrës për klasën e dytë nr. 26-1410/1 të datës 14.10.2022 i miratuar nga Komisioni kombëtar i teksteve mësimore.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

373.3.016:5(075.2)=163.3

KIRKOVSKA, Sonja

Shkencat natyrore për klasën e dytë : viti shkollor 2022/2023 /  
Sonja Kirkovska, Nela Slezenkova-Nikovska ; [Ilustrimet Anastasia  
Dimitrova ; përkthyer nga gjuha maqedonase Neshe Salih]. - Shkup :  
Ministria për arsim dhe shkencë e Republikës së Maqedonisë së Veriut,  
2022. - [90] str. : илустр. ; 26 см

Превод на делото: Природни науки за второ одделение / Соња Кирковска,  
Нела Слезенкова-Никовска. - Содржи и: Shtojca

ISBN 978-608-273-168-1

1. Slezenkova-Nikovska, Nela [автор]

COBISS.MK-ID 58671109

I dashur nxënës,  
E dashura nxënëse,

Para jush është teksti shkollor i Shkencave natyrore. Ai do t'ju ndihmojë që të zbuloni shumë gjëra interesante rreth:

- qenieve të gjalla dhe venbanimet tyre;
- bimëve që lulëzojnë;
- origjinës, vetive dhe përdorimit të materialeve;
- Tokës, Diellit dhe Hënës;
- energjisë

Sa më shumë të zbuloni sekretet e natyrës, aq më shumë do ta doni atë dhe do të kujdeseni për të. Shikoni me kujdes figurat, vizatoni, ngjyrosni, plotësoni, hulumtoni, përgjigjuni pyetjeve...

Nëse diçka nuk është e qartë për ju, pyesni shokun tuaj, mësuesin ose një të rritur nga familja. Shpresojmë që shoqërimi me tekstin shkollor do të jetë interesant për ju dhe një udhëtim emocionues.

Falënderim të veçantë i kushtohet profesoreshave nga grupi klasor Biljana Lalazarevska dhe Biljana Stojanovska të cilat dhanë kontribut të veçantë për përpunimin e tekstit shkollor.

Nga autorët

# PËRMBAJTJA

KUSHTET PËR RRITJEN E BIMËS.....	7
SI NDIKOJNË KUSHTET PËR RRITJEN E BIMËS.....	8
ÇKA NEVOJITET QË BIMËT TË RRITEN?-HULUMTIM.....	9
UJI, DRITA DHE NXEHTËSIA.....	10
UJI.....	11
DRITA.....	11
NXEHTËSIA.....	11
PËRCJELLJAEUJITNËPËRBIMË.....	12
BIMËT QË LULËZOJNË - PËRSËRITJE.....	14

## 3

### ORIGJINA, VETITË DHE PËRDORIMI I MATERIALEVE

MATERIALET NGA ORIGJINA NATYRORE DHE ARTIFICIALE	16
AKTIVITET HULUMTUES PËR VETITË E MATERIALEVE	19
VETITË E MATERIALEVE	20
PËRDORIMI I NDRYSHËM I MATERIALEVE PËRDORIMI I MATERIALEVE	23

VETITË E MATERIALEVE DHE PËRDORIMI I TYRE	24
OBJEKTE TË PËRPUNUARA NGA MË SHUMË MATERIALE	25
ORIGJINA, VETITË DHE PËRDORIMI I MATERIALEVE-PËRSËRITJE	26

# 4

## TOKA, DIELLI DHE HËNA

AKTIVITETHULUMTUES: TOKA, DIELLI DHE HËNA.....	30
DITA DHE NATA.....	30
DIELLI ËSHTË YLL.....	30
BURIMI MË I MADH I DRITËS DHE I NXEHTËSISË.....	30
LËVIZJA E TOKËS RRETH BOSHTIT TË VET.....	33
ANËT E BOTËS.....	34
HIJA GJATË DITËS.....	35
TOKA RROTULLOHET RRETH DIELLIT.....	36
KARAKTERISTIKAT E STINËVE TË VITIT.....	38
HËNA ËSHTË TRUP QIELLOR.....	40
TOKA, DIELLI DHE HËNA-PËRSËRITJE.....	41

# 5

## ENERGJIA

ENERGJIA.....	44
MËNYRAT E PËRFITIMIT TË ENERGJISË.....	46
BURIMET E ENERGJISË.....	47
NXEHTËSIA.....	48
SI FITOHET NXEHTËSIA?.....	49
TEMPERATURA DHE NXEHTËSIA E TRUPAVE.....	50
MATJAE TEMPERATURËS.....	52
DRITA.....	53
BURIMET E DRITËS.....	54
SI UDHËTON DRITA.....	55
PARAQITJAEHIJEVE.....	56
MASAT E KUJDESIT DHE PËRDORIMI I RREGULLT	
I MJETEVE ELEKTRIKE.....	57
QARKUELEKTRIK.....	58
ELEMENTETE QARKUTELEKTRIKDHEFUNKSIONIITYRE.....	60
TERMOCENTRALET-PRODHUESIT E RRYMËS ELEKTRIKE.....	62
KURSIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE.....	63
ENERGJIA-PËRSËRITJE.....	64
SHTOJCA.....	65

# UDHËZIME PËR NXËNËSIT:



RIKUJTO




PËRSHKRUAJ/TREGO




VËZHGO/  
HULUMTO



VIZATO/  
SHKRUAJ




LIDH



NGJYROS



PREJ



NGJIT



LEXO



E RËNDËSISHME




# KUSHTET PËR RRITJEN E BIMËS



Numëro çka është e nevojshme për rritjen e bimës, kurse pastaj ngjyrosi.





DRITË



UJË



NXEHTËSI



# SI NDIKOJNË KUSHTET PËR RRRITJEN E BIMËS




Në një pyll, afër një livadh, i drejtë dhe krenar jetoj një lis. Ai mezi priste diellin pranveror i cili i solli një shtroje të gjelbër.



Koha po kalonte dhe erdhi vjeshta. Lisi tani kishte mbulesë të re të vverdhë-kafe. Ai kujdesej se me ardhjen e dimrit edhe ai do të zhduket.

## MENDO DHE SHPJEGO

Pse pamja e lisit është e ndryshme në pranverë, verë, vjeshtë dhe dimër? Vizato se si duket lisi i vjetër në dimër!



Vizato se çka është e nevojshme që bimët të rriten dhe të zhvillohen në mënyrë të rregullt. Pastaj ndaj idetë me shokun tuaj.





# ÇKA U NEVOJITET BIMËVE QË TË RRITEN-HULUMTIM



Ky do të jetë hulumtim dhe vëzhgim, që të mund të shihni se çka ndodh me bimët tuaja në kushte të ndryshme.



Zgjidhni një nga pyetjet me shokët tuaj dhe hulumtoni.



1. Çfarë do të ndodhë me bimën që **nuk ka ujë**?  
Përdorni shtojcën 8



2. Çfarë do të ndodhë me bimën që **nuk ka patur dritë**? Përdorni shtojcën 9.



3. Çfarë do të ndodhë me bimën nëse e vendosim në **vend të ftohtë**? (frigorifer)  
Përdorni shtojcën 10.



Bisedoni me shokët tuaj për këtë çfarë parashikoni që do të ndodhë dhe vizatoni planifikuesin për kërkime.



Gjatë ditëve në vijim, rregullisht vëzhgoni bimën tuaj dhe shikoni nëse vëreni ndonjë gjë. Nëse vëreni se diçka po ndodh ose po ndryshon, regjistroni në planin për kërkime. Kur të keni mbaruar së vëzhguari, do të shikoni rezultatet dhe do të zbuloni nëse parashikimi është i njëjtë me rezultatin.





Ju mund të përdorni figura dhe fjalë për të shpjeguar idetë tuaja në planifikuesin e kërimit. Mos harroni të matni lartësinë e bimës në mënyrë që të mund të vini re nëse dhe sa është rritur në fund të kërimit.

# UJI, DRITA DHE NXEHTËSIA

Të gjitha qeniet e gjalla kanë nevojë për **kushte të caktuara** për t'u rritur dhe të jenë të shëndetshëm.



## KUSHTET PËR RRIJJE TË BIMËVE



## UJI

Fara ka nevojë për ujë për të **mbirë**. Uji i bën të mundur farës të zbutet, ndërsa rrënjët dhe kërcelli fillojnë të **rriten**. Ai i ndihmon të transportojnë lëndët ushqyese nga toka përmes **rrënjëve** të bimës.



**Gjethet** e bimës kanë nevojë për ujë për t'i ndihmuar që t'i **shndërrojnë** rrezet e diellit në ushqim.

Është e rëndësishme që bimët të marrin një sasi të mjaftueshme të ujit që të rriten dhe zhvillohen si duhet. Nëse bimët nuk kanë ujë të mjaftueshëm, ato do të **thahen**. Por ato gjithashtu mund të veniten nëse kanë **shumë** ujë.



## DRITA




Rrezet e diellit i ndihmojnë bimët që të **rriten**. Gjethet i **shndërrojnë** rrezet e diellit në **ushqim** për bimët.



Disa bimë duhet të qëndrojnë në **diell**, ndërsa të tjerat pjesërisht duhet të jenë në **hije**.

## NXETËSIA



**Nxehtësia** ndikoi në rritjen dhe zhvillimin e duhur të bimës.

Bimët kanë nevojë për nxehtësi që të mund t'i **shndërrojë** rrezet e diellit në ushqim.



Në pranverë, nxehtësia i ndihmon bimëve që sythat të zhvillohen, farat e mbjella të **mbijnë** në tokë, kurse fidanët të rriten më shpejt.



Kaktusit i duhet **shumë nxehtësi** që të rritet dhe zhvillohet.


Lulet e bardha mund të rriten dhe të jenë të shëndetshme me **më pak nxehtësi**.

# PËRCJELLJA E UJIT NËPËR BIMËN



Cili është roli i kërcellit?

Eksperiment:



Materialet e nevojshme:

- ✓ Dy kavanoza të tejdukshme
- ✓ Dy thasë me ngjyra ushqimore (e kuqe dhe e kaltër)
- ✓ Dy kërcëj selino

## Aktivitet 1

Mbushni të dy kavanozat përgjysmë me ujë. Në një kavanoz shtoni ngjyrën e kuqe dhe në tjetrën shtoni ngjyrën e kaltër. Mirë përzieni për të barazuar ngjyrën. Vendosni një kërcell selino në secilën nga kavanozët. Sigurohuni që të dy kërcëjtë të jenë përafërsisht në të njëjtën madhësi. Çfarë do të ndodhë me kërcëjtë e selinos ditën tjetër?



Vëzhgoni! Çfarë ngjyre kanë gjethet të nesërmen?

## Aktivitet 2

Qëroni kërcellin e selinos, merrni një xham zmadhues dhe shikoni pjesën e ngjyrosur.

1. Pse është pakësuar uji në kavanoza?
2. Përshkruani atë që shihni me xhamin zmadhues.



Vizatoni se çka vërejtët në fillim, dhe çka në fund.

NË FILLIM

NË FUND



Shpjego si pi ujë me gyp. Si transmetohet uji nga gota deri te goja jote?



3.



2.

1.



1. Rrënjët e thithin ujin nga toka.
2. Kërçelli e përcjell ujin nga gjethet.
3. Uji avullon nga gjethet.



Ngjyros, vizato shigjetat për përcjelljen e ujit nëpër bimën, lidh dhe shpjego!

Uji avullon nga gjethet.

Rrënjët e thithin ujin nga toka.

Kërçelli e përcjell ujin nga gjethet.



# BIMËT QË LULËZOJNË - PËRSËRITJE

## RRETHO

1. Rretho atë që paraqet pjesë të bimës:

a) lulja                      b) bishti                      c) krahët

2. Në cilën pjesë të bimës krijohet ushqimi?

a) lule                      b) kërcell                      c) gjeth

3. Çka u nevojitet bimëve që të mund ta shndërrojnë ditën diellore në ushqim?

a) fara                      b) nxehtësi                      c) kripë



## PLOTËSO

4. Rrënja, kërcelli, gjethi , fruti dhe fara janë pjesë të bimës.

5.  bën bartjen e ujit dhe ushqimit dhe e mban bimën të drejtuar.

6. Të gjitha qenieve të gjalla u nevojiten këto kushte që të rriten dhe të jenë të shëndetshme:

## PËRGJIGJU

7. Pse i nevojitet bimës uji, drita dhe nxehtësia?

---

---

8. Shpjego çfarë roli ka gjethi i bimës!

---

---

9. Çfarë do të ndodhë me bimën kaktus nëse e mbjellim në pyll?

---

---

# ORIGJINA, VETITË DHE PËRDORIMI I MATERIALEVE


MATERIALE  
NATYRORE DHE  
ARTIFICIALE

VETITË E  
MATERIALEVE

PËRDORIMI I  
MATERIALEVE



# MATERIALET NGA ORIGJINA NATYRORE DHE ARTIFICIALE



## Të përkujtohem!

Nga se janë të përpunuar objektet rreth nesh?

Për materialet keni mësuar në klasën e parë. Duke i përdorur njohuritë e vitit të kaluar mundohuni t'i gruponi materialet e fotografive të mëposhtme në dy grupe. Ndiqni shembullin!



### MATERIE LAE NATYRORE

Druri

---

---

---

---

---

---



**Materialet** janë gjithkund rreth nesh. Ato përdoren që të përpunohen objektet. **Objektet** mund të jenë të përpunuara nga lloji i ndryshëm i materialeve.

### MATERIE LE ARTIFICIALE

Plastika

---

---

---

---


---

---

### MATERIALET



DRURI



METALI



PAMBUK



PLASTIKA



LESHI



MËNDAFSH



NAJLONI



QELQI



GOMA



GURI



QERAMIKA



LETRA



POLISTEROLI



**Materialet** mund të jenë **natyrore dhe artificiale**. **Materialet natyrore** kanë origjinën nga bimët, shtazët, shkëmbinjtë... **Materialet artificiale** i krijojnë dhe i përpunon vetë njeriu për nevojat e veta.





Sot në orën e shkencave natyrore, Nikolla mësonte për materialet. Ishte i fascinuar nga ndryshueshmëria e materialeve nga e cila janë të përpunuar materialet. Vendosi t'i ndajë njohuritë e tij me shoqen e tij Amina. Ai shpiku një lojë me këto hapa:

- Ai në letër i ngjiti fotografitë e sendeve të ndryshme.
- Ti nën çdo send shëno emrin e materialit.
- Pastaj shëno me shkronjë të madhe **N** për material natyror dhe me shkronjë të madhe **A** për materiale artificiale.

Kjo është loja e Nikollës, shqyrtoni, mendoni, shënoni dhe argëtohuni bashkë me shokun tuaj.

 <input type="checkbox"/>	 <input type="checkbox"/>	 <input type="checkbox"/>	 <input type="checkbox"/>
 <input type="checkbox"/>	 <input type="checkbox"/>	 <input type="checkbox"/>	 <input type="checkbox"/>
 <input type="checkbox"/>	 <input type="checkbox"/>	 <input type="checkbox"/>	 <input type="checkbox"/>



**Mendoni** për ndonjë nga objektet që i përdorim çdo ditë. **Nga çfarë lloj materialesh** janë të përpunuara? Veshja që e veshim është e përbërë nga materiale të ndryshme për shembull **pambuku** dhe **leshi**. Pajisjet për ushqim (thika, lugët dhe piruni) mund të jenë të përpunuar nga **metali, druri ose plastika**. Disa lëndë janë të përpunuar nga më shumë materiale të ndryshme. Për shembull, celularët janë të përpunuar nga **plastika, qelqi, metali** etj.

### Aktivitet

Vizato në fletore tre objekte të përpunuar nga materiali natyror dhe tre objekte nga materiali artificial.

Lexoni përrallën „Tre derrkucët”. Në orën e Gjuhës maqedonase bisedoni për materialet që i kanë përdorur të tre derrkucët për ta ndërtuar shtëpinë e tyre.

Bëhuni kreativë!  
Në orën e Artit figurativ përpiloni origami nga letra.



**Pambuku** është bimë. **Mbin** nga fara. Ai **mblidhet** dhe **përpunohet**. Në ilustrimet shihet procedura e farës së bimës së pambukut deri te peri i pambukut.



### Hulumto!

Hulumtoni procesin se si janë të përpunuar disa nga objektet që i përdor në përditshmëri. Për shembull, gota e qelqit nga e cila pini ujë, lapsi me të cilin shkruan dhe këpucët të cilat i mbath...

### Tregim me fotografi

Shqyrto fotografitë e mëposhtme dhe formulo një tregim. Përdor thesarin e fjalëve: dele, gërshtë, top, lesh, gjilpërë, kapelë...




---



---



---



---



---

# AKTIVITET HULUMTUES PËR VETITË E MATERIALEVE



Data: \_\_\_\_\_

**Pyetje:** Cila çantë përshtatet më mirë për mbajtje të sendeve ushqimore? (e letrës ose prej pambukut)

**Parashikim:** Mendoj se çanta \_\_\_\_\_ përshtatet më mirë për mbajtjen e sendeve ushqimore sepse \_\_\_\_\_.

**Testimi i çantës së letrës dhe të pambukut- Paraqitni rezultatet nga hulumtimi juaj. Që të fitojmë rezultate të sakta gjatë hulumtimit, të dyja çantat duhet të jenë me madhësi të njëjtë.**



Vetitë	Çanta e letrës	Çanta prej pambuku
Elasticitet		
Thithja e ujit		
Shkëputja		

## Përfundim

Shpjego rezultatet nga testimi dhe shëno përfundimin.

---

---

---

Shënoni përdorimet tjera të këtyre materialeve.

---

---

---



# VETITË E MATERIALEVE

## Druri

**Druri është material natyror.** Disa objekte të përpunuar nga druri janë:



Mobile



instrument



anije



letër

**Druri** shpesh përdoret sepse është i **fortë**, mund të gdhendet dhe të përpunohet në çfarëdo forme.

## Pambuku

Disa sende të përpunuar nga pambuku janë:



Shtroje



Veshja



Peshqiri

Pambuku përdoret sepse është shumë i **lehtë**, i **butë**, **elastik**, **thith ujin**...

## Leshi

**Leshi** fitohet nga delet dhe përdoret për përpunimin e perit. Peri përdoret për prodhimin e pëlhurës nga të cilat prodhohet veshja, pjesët e këpucëve etj.

Leshi lehtë përpunohet, kurse është **elastik**.

## Hulumtim

**Elasticiteti** i materialeve të ndryshme.

Merrni llastikë të përpunuar nga goma të ndryshme ose copë tekstili me madhësi të njëjta. Në kushte të njëjta matni gjatësinë të tyre të tërheqjes. Rezultatet paraqitni në fletoret tuaja në mënyrë tabelare dhe radhitni sipas elasticitetit.



## Plastika

**Plastika është material artificial.** Disa sende të përpunuar nga plastika janë:



Topi



Shishe




Gota

## Metali

Disa sende të përpunuar nga metali janë:



Stolitë



Piruni



Automobili

**Metali** përdoret sepse është i **fortë**, i **lëmuar**, mund të jetë edhe **magnetik**. Metalet janë **përçues të mirë të nxehtësisë**, e cila lehtë kalon nëpër to. Materialet tjera nuk lejojnë nxehtësinë të kalojë nëpër to.

## Qelqi

**Qelqi** është i përpunuar nga rëra shumë e imët. Ngrohet deri sa të shkrihet. Disa sende të përpunuar nga qelqi janë:



Syzet



kavanozi



llamba

**Qelqi** përdoret sepse është i **ngurtë**, i **lëmuar** dhe i **tejdukshëm**.

Zgjidhni dy materiale dhe përshkruaj më poshtë në vijat e zbrazëta.

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

-Daris, a e din se disa objekte janë magnetike, kurse disa jo?

-Po, Mia, por që të jemi të sigurt se cilat objekte janë magnetike, kurse cila jo ne duhet t'i kontrollojmë.

-Të përpiqemi me një magneti t'i tërheqim disa objekte.

-Unë kam një kapëse, monedha dhe katrorë të plastikës.

-Shumë bukur, kurse unë kam llastikë të gomës.

Hulumtoni edhe ju me shokun/shoqen tuaj. Pastaj në tabelë radhitni rezultatet e fituara.



### Aktivitet

Punë në grupe

Hulumtoni përçueshmërinë e nxehtësisë tek materialet e ndryshme.

Me ndihmën e prindërve mbusheni një enë me ujë të ngrohur në rreth 40°C.

Merrni lugë metalike, plastikë dhe të drurit dhe në të njëjtën kohë vendosni në enën. Pas një minutë nxirrni jashtë. Me ndihmën e prekjes, kontrolloni shkallën e ngrohjes së lugëve. Vizatoni tabelë në fletoren tuaj dhe radhitni materialet sipas përçueshmërisë së nxehtësisë.

# PËRDORIMET E NDRYSHME TË MATERIALEVE

## PËRDORIMET E NDRYSHME TË MATERIALEVE

Nëse i dimë vetitë e materialeve, kjo na ndihmon të vendosim se cilat materiale janë më të mira për përdorimin e duhur.



Shëno ose vizato shembull të ndonjë sendi që është i përpunuar nga materiali që është i dhënë. Mund ta matni kohën se cili nga ju është më i shpejtë.

QELQI

DRURI

METALI

PLASTIKA

PËLHURA

PAMBUKU

LETRA

QERAMIKA

GURI

GOMA



# VETITË E MATERIALEVE DHE PËRDORIMI I TYRE



Mendoni dhe përgjigjuni në pyetjet e parashtruara.

Sigurisht që më veç e pamë që dritarja është e përpunuar nga **qelqi**.

**Qelqi** është i përshtatshëm për përpunimin e dritareve për shkak të vetive të tyre. Për shkak se është i **fortë** nuk e ndryshon formën. Për shkak se është i **tejdukshëm** mund të shikojmë jashtë si dhe të hyjë dritë brenda.



Emërtoni këtë objekt dhe shënoni se prej cilit material është i përpunuar.

Cilat veti i përmban?

Qelqi është i **fortë**, nuk **lëshon ujë** dhe është i **tejdukshëm**.

Nëse dritarja është e përpunuar nga druri, ai sërish do të jetë i fortë, por nuk do të mund të shikojmë jashtë, as që do të mund ta lëshojë dritën jashtë. Mungon vetia e tejdukshmërisë.

Pse ky send nuk është i përpunuar nga druri? Shpjego!

Mendo dhe shpjego pse pikërisht ai material është i përshtatshëm!

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

Emëro këtë send dhe shëno  
Nga cili material është i përpunuar



Emëro këtë send dhe shëno  
Nga cili material është i përpunuar

Cilat veti i përmban?

---

---

---

---

Cilat veti i përmban?

---

---

---

---

Mendo dhe shpjego pse pikërisht ai material është i përshtatshëm!

---

---

---

---

Mendo dhe shpjego pse pikërisht ai material është i përshtatshëm!

---

---

---

---

Pse ky send është i përpunuar nga plastika? Shpjego!

---

---

---

---

Pse ky send është i përpunuar nga letra? Shpjego!

---

---

---

---



# OBJEKTE TË PËRPUNUAR NGA MË SHUMË MATERIALE



Siç e mësove, objekte të ndryshme janë të përpunuar nga materiale të ndryshme, të cilat mund të jenë natyrore ose artificiale.

Për disa objekte janë të nevojshëm dy ose **më shumë materiale të ndryshme** në varësi nga vetitë e tyre.



Lidhni pjesët e ndryshme të sendeve me materialet nga të cilat janë të përpunuara.



Përgjigju pse pikërisht ai material është përdorur?

DRURI

PAMBUKU

MËNDAFSHI

PLASTIKA

QELQI

POLISTEROLI

LETRA



GURI

LESHI

METALI

GRAFITI

GOMA

QERAMIKA

NAJLONI



# ORIGJINA, VETITË DHE PËRDORIMI I MATERIALEVE- PËRSËRITJE

## RRETHONI

1. Cili nga këto materiale është natyral?

a) pambuku      b) plastika      c) polisteroli

2. Cili nga këto materiale është magnetike?

a) pambuku      b) metali      c) plastika

3. Për shkak të cilës veti të materialit, dritaret janë të përpunuara nga qelqi?

a) Tejdurshmëri      b) elasticitet      c) magnetike



## PLOTËSONI

4. Materialet mund të jenë të përpunuar nga

5.  përdoret sepse është shumë i lehtë, i butë dhe elastik.

6.  është e përpunuar nga rëra e imët dhe ngrohet deri sa të shkrihet.

## PËRGJIGJU

7. Pse njeriu i krijon materialet artificiale?

---

---

---

8. Përgjigju se prej cilit material është i përbërë veshja që e mban sot në shkollë?

---

---

---

9. Prej cilit material është i përpunuar pajisja për shkrim të cilën e përdor?

---

---

---

10. Mendo! Çfarë ka qenë këmisha para se ta sillnin në shitore?

---

---

---





# TOKA, DIELLI DHE HËNA

DITA DHE NATA

ANËT E  
BOTËS

HIJET

STINËT E  
VITIT

HËNA



# AKTIVITET HULUMTUES: TOKA, DIELLI DHE HËNA



Vizato:

DITA

NATA

**Cili është dallimi mes ditës dhe natës?**



Plotësoni tabelën sipas shembullit:

	SAKTË	E PASAKTË
Dielli ndriçon ditën	✓	
Në qiell Hënë e shikojmë vetëm ditën.		
Yjet i shikojmë natën.		
Kur ka Diell është errësirë.		

Përfundim:

Çka është dallimi në mes ditës dhe natës?  
Çka përfundove?

---

---

---

---

---

---



# DITA DHE NATA

## DIELLI ËSHTË YLL

Iva, Mia, Sanela, Xhan, Nikolla përsëri hulumtojnë në laborator.

Mia, po e shikoj Hënën dhe shumë yje.  
**Yjet**, janë trupa qiellorë që ndriçojnë.  
A e dini se çka është Dielli?

Ku është Dielli natën dhe ku ndodhen yjet ditën?

Iva, çka shikon natën në qiell?

A e dini se **Dielli** është yll?

Ashtu është, Nikolla, E njëjta është te libri.

Ndaloni në një vend kur koha është me diell. Shikoni lart. Do të vëreni hapësirë të madhe dhe të pafund. Kjo quhet qiell.

Natën, kur qielli është i kthjellët dhe i qartë, mund të vëreni shumë pika të ndritshme. Ato janë trupa qiellorë që ndriçojnë, dhe quhen **yje**.  
**Dielli** është ylli më i afërt i Tokës. Ka yje që janë shumë më të mëdhenj nga ai, por për shkak se janë më larg Tokës, mund t'i vërejme vetëm si trupa qiellorë të vegjël dhe të ndritshëm.

Ndihmoi Xhanit që të përgjigjet në pyetjet.

Ku ndodhet Dielli natën?

Ku gjenden yjet ditën?

## BURIMI MË I MADH I DRITËS DHE I NXEHTËSISË



Trupat që rrezatojnë dritë i quajmë **burime të dritës**. Shqyrtoni fotografitë dhe përgjigjuni në pyetjet e parastruara:



Të njëjtat a janë edhe burime të nxehtësisë?

Cili burim i dritës dhe i nxehtësisë asnjëherë nuk shuhet?



Që të mund të shikojmë, na duhet dritë. Tanimë zbulove disa burime të dritës dhe të nxehtësisë.

**Dielli** me rrezet e ndriçon dhe e ngroh Tokën dhe u jep jetë njerëzve, bimëve dhe shtazëve.

Ai është **burimi më i madh i nxehtësisë dhe i dritës**.

Kur nuk ka dritë, atëherë është **errësirë**.

Kur nuk ka dritë diellore, atëherë është natë.

Prandaj përdorim burime tjera të dritës. Çka mendon cilat janë ato?




### Me rëndësi:

Asnjëherë mos shiko drejtpërdrejt në Diell, sepse drita e tij është aq e fortë që mund t'i dëmtojë sytë.



## LËVIZJA E TOKËS RRETH BOSHTIT TË VET



Ishte një ditë pranvere. Bojani dhe Martina shkolin për në shkollë. Dielli ndriçonte shumë. Diçka e çuditshme ndodhi në pushimin e gjatë. Bojani i emocionuar vërejti:


-Shiko, Martina, Dielli ka lëvizur nga mëngjesi!

Martina buzëqeshi dhe u përgjigj:

-Dielli nuk lëviz, por Toka lëviz (rrotullohet) rreth Diellit.

Hynë në klasë dhe ia treguan mësuesit. Ai i shikoi dhe buzëqeshi, duke thënë:

-Të lumtë, Martina. Pikërisht sot do ta mësojmë këtë. Le të shikojmë se pse na duket sikur Dielli lëviz?



**Gjatë ditës mund ta shikojmë Diellin në pozicione të ndryshme.**



Kjo ndodh për shkak se Toka rrotullohet rreth **boshtit** të vet, një herë e kthyer nga Dielli, kurse tjetër herë jo. Kjo dukuri quhet **ditë** dhe **natë**. Kur Dielli e ndriçon një të dytën e tokës, atëherë është ditë. Ndërsa në pjesën e pa ndritshme është natë. Kjo ndodh për një **ditë e një natë**, pra për **24 orë**.



### Aktivitete

Në pjatën prej letre vizatoni linjën në mes.  
Në gjysmën e parë vizato ditën,  
Tokës, dhe në tjetrën natën.



Në klasë luani në role. Një nxënës le të jetë Dielli, duke lëvizur llambë baterie në duar. Tjetri le ta luajë rolin duke u rrotulluar rreth vetes rreth Diellit.

# ANËT E BOTËS




**Anët** e botës janë: **lindje**, **perëndim**, **veri** dhe **jug**.



Dielli lind në **lindje**, kurse perëndon në **perëndim**. Pasdite Dielli është në **Jug**. Asnjëherë nuk është në **veri**.

Kjo është Jana nga klasa II-2. Ajo gjendet në natyrë dhe dëshiron t'i caktojë anët e botës. Jana është e kthyer nga veriu.



V

P

L

J

## Anët e botës

Nëse shkoni në **lindje**, mund të shohësh përrua të cekët, e nëse shkon në **perëndim**, do të mbërrish në një ujëvarë. Nëse shkoni në **veri** do ta takosh xhaxhi Enverin. Ai me një përmendë punon arën deri në **jug**.

Ndihmoi Janës që të përgjigjet në këto pyetje:

- Në cilën anë të botës ndodhet pylli?
- Ku ndodhen shtëpitë?
- Në cilën anë të botës është maja e kodrës?
- Në cilën anë të botës janë delet?

## Aktivitet

Përpiloni një këngë ose një numërues për anët e botës, të ngjashëm me tonën.

# HIJA GJATË DITËS



## Aktivitet

### Vizatimi i hijeve në oborrin e shkollës:



#### Punë në grupe

Në orën 8 të mëngjesit në oborrin e shkollës me shokun tuaj vizatoni hijet e njëri tjetrit me shkumës. Të njëjtin veprim bëjeni edhe në orën 12. Çka vëreni? Cila hije është më e gjatë?



**Hijet** që paraqiten tek objektet e ndryshojnë pozitën dhe madhësinë gjatë ditës. Në mëngjes dhe pasdite hija është **më e gjatë**, ndërsa në mesditë është **më e shkurtër**.

#### Si formohet hija?

**Hija** formohet kur rrezet e diellit nuk mund të kalojnë nëpër disa objekte dhe krijesa të patejdukshme. Domethënë, hije të tyre kanë njerëzit, shtazët, bimët dhe të gjitha objektet rreth nesh.

**Bëje vetë!** Lidhni duart me hijet e tyre. Në mbrëmje me ndihmën e llambës së dorës bëje këtë në murin e shtëpisë suaj.



# STINËT E VITIT

## TOKA LËVIZ RRETH DIELLIT




Sot Nikolla feston ditëlindjen. Ai është i lindur në fund të verës, ditën e fundit të pushimit veror, në 31 gusht. Në vizitë erdhën shokët e tij me të cilët mëson në shkollë: Iva, Xhan dhe Sanella. Xhani i dhuroi një glob. Xhani para një jave u kthye nga vendi i largët, Australia, e cila ndodhet në pjesën jugore të Tokës. Ai në glob u shpjegonte se ku ka qenë. U tregoi se në Australi ka mbajtur xhaketë dimërore, kapelë, shall, dorëza dhe çizme, pasi që atje tani është dimër. Shokët e tij ishin të habitur...Te ne është verë dhe të gjithë jemi të veshur me tesha të holla. Pse ndodh kjo? **Pse në disa vende në botë është dimër, e në disa vende tjera është verë? Pse ekzistojnë stinët e vitit?**


**Toka në të njëjtën kohë lëviz rreth boshtit të vet dhe rreth Diellit**



TË MËSOJMË




Shkencëtarët kanë llogaritur se tokës i nevojitet rreth **365 ditë ose një vit** që të bëjë një rrotullim të plotë rreth Diellit.



Ndryshimi i stinëve të vitit bëhet për shkak të **lëvizjes së Tokës rreth Diellit**. Stinët e vitit ndryshojnë, sepse **boshti i Tokës është i pjerrët**. Pjesa në të cilën është i anësuar kah Dielli është më i nxehtë, sepse drita e Diellit bie direkt deri në sipërfaqen e Tokës. Kjo do të thotë se kur në pjesën e veriut të Tokës është verë, në pjesën jugore është dimër.



Plotëso diagramin sipas pozitës së Tokës, shëno stinën dhe ngjyrose.



### Mendo dhe përgjigju:



1. Cila stinë vjetore është tani?
2. Në cilën stinë vjetore je lindur ti? Përshkruaje ose ilustroje!
3. Nëse sot është ditëlindja jote, sa kohë do të kalojë deri në ditëlindjen tënde të ardhshme?
4. Vizato se si Toka lëviz rreth Diellit.

# KARAKTERISTIKAT E STINËVE TË VITIT



Në një vit ndryshojnë **katër stinë vjetore**. Çdo stinë vjetore zgjat rreth **tre muaj**. Ato janë: **pranvera, vera, vjeshta dhe dimri**. Ato kanë karakteristika të veçanta.

Në **pranverë** koha fillon të ngrohet. Natyra zgjohet. Drunjtë lulëzojnë, ndërsa bari gjelbërohet. Shpendët kthehen nga vendet e nxehta, ndërsa shtazët zgjohen nga gjumi dimërorë. Njerëzit fillojnë të punojnë në fushat e tyre.


Koha e lirë shfrytëzohet për shëtitje në natyrë.

Në **verë** koha është më e nxehtë. Dita është më e gjatë dhe Dielli shkëlqen më fort. Nëpër fusha korret drithi. Frutat më të bukura dalin në verë.

Viti shkollor përfundon dhe pushimet verore fillojnë. Bëhemi gati për pushime.





Në **vjeshtë**, gjethet e pemëve fillojnë të zverdhen dhe bien në tokë, moti bëhet më i ftohtë dhe shpesh bie shi. Njerëzit mbledhin frutat nga fushat dhe oborret dhe bëjnë ushqim për dimër. Arat lëvrohen dhe mbillen. Shpendët migrojnë në rajone më të ngrohta. Kafshët në pyll mbledhin ushqim për të kaluar dimrin.

Në **dimër**, moti është i ftohtë, bie borë. Dielli shkëlqen më rrallë dhe netët janë të gjata. Kafshët fshihen në vendbanimet e tyre dimërore. Disa kafshë, si ariu, iriqi dhe të tjera janë në një gjumë të thellë dimëror. Vetëm bredhat dhe pishat janë të gjelbra.





Plotësoni tabelën.

	PRANVERË	VERË	VJESHTË	DIMËR
			Në pemën e mollës ka fruta të pjekura.	Degët e pemës janë të mbuluara me borë.
		Dielli shkëlqen. Moti është i nxehtë.	Bie shi. Gjethet bien	
	Kthehen dallëndyshet e para		Dallëndyshet përgatiten për shtegtim në jug	
				Ariu është në gjumin dimëror.



Natyrë ndryshon sipas stinëve të vitit. Përputhni vizatimet me stinën e duhur.



PRANVERA



VERA



VJESHTA



DIMRI



# HËNA ËSHTË TRUP QIELLOR



Pse Hëna ndriçon?

Vetë Hëna **nuk ndriçon**. Ajo nuk është burim i dritës, por është **e ndriçuar nga Dielli**.

Ju duhet të keni parë Hënën para se të shkoni në shtrat. Ajo shpesh duket se ndryshon formën e saj. Pse është kështu? Hëna lëviz **rreth Tokës** gjithmonë në të njëjtën rrugë. Për këtë i duhet rreth **një muaj**.

Në periudha të ndryshme të muajit, Hëna duket ndryshe. Kjo ndodh sepse, përdherisa Hëna rrotullohet rreth Tokës, Dielli ndriçon pjesë të ndryshme të saj.




**Fazat/menytë** e Hënës janë: **tremujori i parë, hëna e plotë, tremujori i tretë dhe hëna e re**.



**Hëna e re** është errësuar plotësisht dhe ne nuk mund ta shohim atë.



**Hëna e plotë** është plotësisht e ndriçuar si rreth i rumbullakët me shkëlqim.




**Tremujori i parë** ne e shohim atë si një gjysmëhënë.



**Tremujori i tretë** është gjysmëhëna e ndriçuar e kundërta e të parës një çerek.

## Aktivitete



Bëni modelin sipas hapave të dhënë dhe shpjegoni lëvizjen e Hënës (shtojca nr. 11)

Renditni fazat e Hënës (shtojca nr. 113)

Shkruani një përbërje ose vizatoni një vizatim me Temë: "Udhëtimi im në Hënë"



# TOKA, DIELLI DHE HËNA-PËRSËRITJE

## RRETHONI

1. Çfarë është Dielli?

a) yil                      b) planet                      c) qiell

2. Sa orë zgjat dita dhe nata?

a) 12 orë                      b) 24 orë                      c) 23 orë

3. Çfarë ndodh kur rrezet e diellit nuk mund të kalojnë nëpër disa objekte?

a) nxehtësi                      b) dritë                      c) hije

## PLOTËSONI

4. Stinët janë: , ,  dhe .

5. Anët e botës janë    dhe .

6. Burimi më i madh i dritës dhe nxehtësisë është .

## PËRGJIGJU

7. Në cilën anë të botës do të jetë dora e majtë, nëse fytyra jote është e kthyer kah Dielli në mesditë?

---

---

8. Çfarë ngjyre do të jetë hija juaj nëse vishni pantallona jeshile?

---

---

9. Për çka dallohen stinët pranvera dhe dimri?

---

---

10. Si janë të ngjashme stinët e vjeshtës dhe pranverës?

---

---





# ENERGJIA

ENERGJIA

DRITA

NXEHTËSIA

ENERGJIA  
ELEKTRIKE



# ENERGJIA



Çfarë bëni kur keni shumë energji? Ndoshta vraponi në parkun e afërt, kërceni në litar, këndonni këngë dhe luani valle, ngisni biçikletë, lozni me top...

Vizatoni! Çfarë bëni kur keni shumë energji?

Vizatoni! Çfarë bëni kur keni shumë pak energji?

Vizatoni! Nga çfarë merrni energji?

Vizatoni! Si bimët dhe shtazët fitojnë energji?



**Energjia është aftësia për të lëvizur ose ndryshuar diçka.** Për çdo gjë që bëjmë nevojitet energjia. Ajo është gjithandej rreth nesh. Njerëzit, kafshët dhe bimët kanë nevojë për energji.

Shënoni! Me ndihmën e kujt do të lëvizin objektet?



Era





Lexoni tregimin dhe shqyrtoni ilustrimet.

Për çka u nevojitet energjia fëmijëve?

Çfarë e lëviz makinën?

A ka nevojë për energji? Pse?

Ilustroni aktivitetet në shkollë!

## Të gjithë së bashku

Dita është me diell dhe e ngrohtë. Familja Ristevski shkuan në një vizitë te gjyshi dhe gjyshja në fshat.

Udhëtuan gjatë dhe ishin shumë të uritur. Gjyshja Spasija në sobën e drurit po gatuate drekën. Të gjithë ndihmuan në shtrimin e tryezës. Për pak kohë ata shijuan një ushqim të shijshëm. Ata gjatë kohë nuk ishin parë, kështu që të gjithë donin të thonin diçka interesante... Nxehhtësia që vinte nga soba ku ishte ndezur zjarri e bënte bisedën edhe më të këndshme.

Pasdite Jana dhe Ege dolën jashtë në livadh. Ege e lëshoi fluturaken në ajër, ndërsa Jana kërcente me litar. Në një momenti fluturakja e Eges nuk vazhdoi të fluturonte.

- Pse nuk mundet më të fluturojë fluturakja, Ege? - e pyeti Jana.

- Mendo, Jana! Me ndihmën e kujt fluturon fluturakja?

- U kujtova! Era nuk është aq shumë e fortë tani.

- Eja, Jana, ikim tani do të errësohet.

- Mos u shqetëso Ege, unë kam llambë të dorës. Ajo do të na e ndiçojë rrugën.

- Jana, unë më shumë do të doja të mos t'i shqetësoj prindërit.

- Ashtu është, Ege. Eja tani shkojmë para se të errësohet.

# MËNYRAT E PËRFITIMIT TË ENERGJISË



Mendo dhe vizato se si  
përgatitet çaji!  
Çka do të ndodhë me ujin e ftohtë?



Mendo dhe vizato se çka  
është e nevojshme kur  
lexon libër në mbrëmje?

H<sub>2</sub>O



CO<sub>2</sub>



Bëni  
lidhjen  
rinë



NDRIÇIM  
DRITË



DJEGIE  
KARBURANT



NGROHJE  
NXEHTËSI



# BURIMET E ENERGJISË



Ka shumë mënyra të ndryshme për të përfitur **energji**. Gjërat që prodhojnë energji janë **burime energjie**.



Burimi më i madh i energjisë është Dielli. Ekzistojnë gjithashtu burime të tjera të energjisë siç janë: era, uji, gazi natyror, nafta, qymyri.




Gjeni dhe ngjyrosni burimin përkatës të energjisë.

Robot- lodër				
Automobil				
Hidrocentral				
Mullinj ere				

# NXEHTËSIA



**Nxehtësia** është një lloj **energjie**. Dielli është burimi më i madh i **nxehtësisë** dhe dritës. Pa nxehtësinë dhe dritën e tij nuk ka jetë në Tokë. Përveç Diellit, dallojmë edhe burime të tjera të nxehtësisë.



! Kini kujdes si i përdorni pajisjet elektrike.




Lidhni pohimet me figurat e dhëna dhe nxirrni një përfundim pse na duhet energjia e nxehtësisë!

Nxehtësia nga ngrohësi na nevojitet që të na ngrohin në dimër.



Nxehtësia nga zjarri na duhet për të gatuar ushqim.



Uji i nxehtë na nevojitet për të bërë dush.



Nxehtësia nga Dielli na nevojitet që të na thahen rrobat.





## SI E FITOJMË NXEHTËSINË?



Imagjinoni që jeni jashtë në dimër, kurse i keni harruar dorezat. Duart e tua janë të ftohta. Çfarë do të bëni për t'i ngrohur ato?



Duke fërkuar pëllëmbët fitohet nxehtësia.

Në të kaluarën e largët njerëzit për të ndezur zjarrin janë shërbyer duke **fërkuar** dy shkopinj druri.



Ekzistojnë disa lloje të burimeve natyrore të nxehtësisë. Me **djegje të lëndëve** djegëse fitohet nxehtësia dhe drita.

**Qymyri** është një lëndë djegëse e ngurtë që nxirret nga brendësia e tokës.

**Gazi** është lëndë djegëse në gjendje të gaztë ose të lëngët.

**Nafta** është një lëng i ndezshëm me ngjyrë të errët në të gjelbër. Përdoret si lëndë djegëse për automjetet.

**Druri** është lëndë e parë e ngurtë djegëse përdorur nga njeriu parahistorik. Nga **qymyri, gazi, nafta dhe druri** fitohet energji e nxehtësisë. Atë mund ta përdorim në mënyra të ndryshme.



Druri



Qymyri



Nafta



Gazi

### Aktivitet

Hulumtoni për çka përdoret energjia e nxehtësisë në shtëpitë tuaja!



# TEMPERATURA DHE NXEHTËSIA E TRUPAVE



Shikoni figurat dhe mendoni! Çfarë do të ndodhë me akulloren? Çfarë do të ndodhë në dy figurat? Çfarë ndryshimesh do të ndodhin?









H<sub>2</sub>O

CO<sub>2</sub>






Në jetën e përditshme, shpesh mund të vëreni gjëra të tilla apo shembuj të ngjashëm. Mundohuni t'i shpjegoni disa prej tyre. Plotësoni tabelën duke vizatuar dhe shkruar në katrorët e zbrazëta. Krahasoni përgjigjet tuaja me shokun tuaj.

	+		=		Shkrirje
	+		=		Avullim
	+		=		



Me ngjyrë të **kaltër** ngjyrosni objektet e ftohta, ndërsa me të **kuqe** objektet e nxehta.




Në cilën stinë vjetore është më nxehtë? Si ndikon nxehtësia te djali dhe vajza në figurë? Cila stinë vjetore është më e ftohtë? Shpjegoni pse fëmijët janë të veshur ndryshe në dy figurat?



temperaturë e lartë

temperaturë e ulët



# MATJA E TEMPERATURËS



Termometër dixhital për matjen e temperaturës trupore.



Termometër dixhital për matjen e temperaturës së dhomës.



H<sub>2</sub>O



## Aktivitet

### Matja e temperaturës së dhomës me termometër dixhital.

Matni temperaturën e trupit tuaj me termometër dixhital gjatë një jave, rezultatet e fituara regjistroni në tabelën e dhënë dhe krahasoni ato me shokun tuaj.

	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte
Data					
Ora					
Temperatura					

CO<sub>2</sub>



## Aktivitet

### Matja e temperaturës së dhomës me termometër dixhital.

Ndahuni në tre grupe

**Grupi i parë:** Zgjidhni tre vende në klasën tuaj ku mendoni se temperaturat do të jenë të ndryshme. Matni temperaturën në çdo vend.


**Grupi i dytë:** Zgjidhni tri klasa në shkollën tuaj ku mendoni se temperaturat do të jenë të ndryshme. Matni temperaturën në çdo klasë.

**Grupi i tretë:** Zgjidhni tre vende jashtë shkollës ku mendoni se temperaturat do të jenë të ndryshme. Mateni temperaturën në çdo vend.

**Përgjigjuni dhe krahasoni rezultatet me grupet e tjera. Cili vend është më i ngrohtë? Cili vend është më i ftohtë? Pse mendoni se është kështu?**



# DRITA



Përveç se **Dielli** është **burimi** më i madh i nxehtësisë, është gjithashtu **burimi më i madh i dritës**. **Drita** na ndihmon të shohim gjërat rreth nesh. Drita është një **lloj energjie**. Bimët kanë nevojë për dritë.



Numëro tre burime të dritës dhe nxehtësisë.  
Numëro tri arsye pse kemi nevojë për dritë dhe ngrohtësi.

1. Na duhet \_\_\_\_\_ që të vozisim natën.
2. \_\_\_\_\_ është burimi më i madh i dritës.
3. \_\_\_\_\_ duhet dritë për të mbijetuar.
4. Çfarë është drita?
5. Nga vjen drita?
6. Si e përdorim dritën?



## Aktivitet

Vëzhgoni të njëjtat sende në errësi, pjesërisht të ndezur dhe hapësirë të ndritshme.  
Diskutoni se çka keni vënë re në të tri situatat e dhëna. Cilat ndryshime i vërejtët? Vizatoni!

## BURIMET E DRITËS



Dielli

rrufeja

llamba

qiriri

llambë baterie

H<sub>2</sub>O











Vizato burimet e tjera të dritës.



Ngjyrosni me të **verdhë** katrorët në figurë që tregojnë burim të dritës dhe me të **gjelbër** për figurat që nuk tregojnë se është burim i dritës.

CO<sub>2</sub>

	<input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>


Drita ndriçon hapësirën përreth nesh dhe shqisa e shikimit (sytë) regjistrojnë dritën.

Për të parë gjërat duhet të ketë një burim drite. Burimet e dritës ndahen në: **natyrore** (dielli, yjet, xixëllonjat-insektet, rufeja) dhe **artificiale** (bateria, qiri, llamba, etj).


**Hëna** nuk është burim drite.



# SI UDHËTON DRITA



**Drita** gjithmonë udhëton në një **vijë të drejtë**. Nëse drita gjendet në objekt, ajo **dëbohet** nga ai dhe arrin në sytë tanë. Atëherë mund t'i shohim objektet. Disa objekte reflektojnë dritën më shumë dhe disa më pak.



Vizatoni rrezet e dritës së Diellit sipas shembullit më lart.

Ngjyrosni katrorin, ku drita udhëton në linjë të drejtë.



# SHFAQJA E HIJEVE



## Të përkujtohem!

Çfarë mësuam për hijen!

Në cilën pjesë të ditës hija është më e gjatë?

Në cilën pjesë të ditës hija është më e shkurtër?

H<sub>2</sub>O



Nëse në rrugën e dritës gjendet pengesa, objekti që është i **padukshëm**, rrezet e dritës nuk mundën të kalojnë nëpër të. Ato janë të penguar dhe prandaj në anën e kundërt të burimit të dritës paraqitet hapësira e errët të cilën e quajmë **hije**.



## Hulumtoni!

Me ndihmën e një llambë baterie ose dritën e telefonit, hulumtoni formimin e hijeve nga objekte të ndryshme (laps, gome, plastikë transparente, gotë/kavanoz qelqi, shami, fletore etj).



**Hija çdo herë formohet në anën e kundërt të dritës.**

CO<sub>2</sub>



Disa objekte dhe materiale nuk e lëshojnë fare dritën (metal, karton, dru etj.), disa e lëshojnë atë pjesërisht (najloni, letra etj.), dhe disa e transmetojnë plotësisht (qelqi). Objektet që transmetojnë plotësisht dritën janë të **tejdukshme**.



## Aktivitet

Në orën e Artit figurativ, bëni skena dhe kukulla letre nga tregimi juaj i preferuar ose krijoni tuajin. Ngjitni kukullat në një shkop. Vendosni një llambë prapa skenës dhe interpretoni tregimin në orën e gjuhës shqipe.






# MASAT E KUJDESIT DHE TRAJTIMI I RREGULLT ME PAJISJET ELEKTRIKE



Në shtëpinë tonë kemi më shumë aparate elektrike. Me aplikimin e tyre na e lehtësojnë jetën tonë. Ato kryesisht punojnë me energji elektrike, kështu që ne duhet të dimë se si t'i **përdorim në mënyrë të duhur** ato. Duhet të jemi shumë të **kujdesshëm**. Përdorni me ndihmën e një të rrituri. Mendoni dhe përgjigjuni çfarë mund të ndodhë nëse nuk e fikim aparatën pas përdorimit?



Mos përdor aparat të prishur.



Mos prekni telat dhe mos ndizni aparatën me kablllo të dëmtuar.



Pas përdorimit të patjetër fikeni atë.



Ne kemi vënë në dukje disa masa paraprake dhe trajtimin e duhur të mjeteve elektrike. Mundohuni të përkujtoni për disa të tjera. Vizatoni dhe shkruani ato më poshtë.



Vëzhgoje fotografinë dhe shkruaj se çka është në **rregull** dhe çka **nuk është në rregull** gjatë përdorimit të aparateve.



E rregullt:




E parregullt:

## QARKU ELEKTRIK



Siç e dini tashmë, disa aparate funksionojnë me energji elektrike. Sigurisht po pyesni veten se si elektriciteti udhëton deri te shtëpitë tona. Rruga përgjatë së cilës transmetohet energjia elektrike është **qark elektrik**. Nga termocentralet përmes kablove arrin energjia elektrike në shtëpitë tona.

Por, ajo nuk rrjedh gjatë gjithë kohës, por ne e kontrollojmë atë.



Rryma mund të prodhohet edhe me ndihmën e baterive. Kështu funksionojnë disa pajisje kur i përdorim.



**Bateria** është një pajisje në të cilën ruhet energjia elektrike.



# ELEMENTET E QARKUT ELEKTRIK DHE FUNSKIONI I TYRE



**Qarku i rrymës** përbëhet nga elementet e mëposhtme:

- bateritë
- telat
- ndërprerësit
- llambat



Ky është **qarku më i thjeshtë i rrymës**. Duhet të jetë i plotë dhe i pandërprerë.


H<sub>2</sub>O



**Llamba** është harxhues i rrymës. Ndrizon kur ka rrymë, por nuk ndizet nëse rryma është e ndërprerë.

**Ndërprerësi** ka funksion për të ndërprerë qarkun e rrymës. Me ndihmën e tij ndërpritet rryma.

CO<sub>2</sub>




**Bateria** është burimi i rrymës, pra prodhuesi.

**Telat** janë përcjellës (transmetues) të rrymës.







Shëno elementet e qarkut elektrik në fushat e zbrazëta.



Mendo dhe shëno a do të ndritë llamba në qarqet e rrymës të paraqitura më poshtë.



# TERMOCENTRALET- PRODHUESIT E ENERGISË ELEKTRIKE



Prodhuesit e energjisë elektrike janë **elektranat**. Ekzistojnë elektrana të ndryshme: mullinj ere, hidrocentrale, termocentrale, central diellor etj.



**Centrali diellor**, me ndihmën e paneleve diellore, energjinë diellore e shndërron në elektrike.



Në **termocentralin** me djegie të karburantit fitohet energjia elektrike.




**Mullinj të** e erës me ndihmën e forcës së erës prodhojnë energji elektrike.



**Hidrocentralet** me ndihmën e forcës së ujit prodhon energji elektrike.



Ngjitni burime në Shtojcën 13 deri në termocentralin e duhur.



Mendo cilat janë pasojat e përdorimit të këtyre resurseve për përfitimin e energjisë elektrike? Shpjego.



## KURSIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE



Tashmë kemi parë se për të fituar energji elektrike ne kemi nevojë për: ujë, erë, diell, karburant... Karburanti është produkt që harxhohet shpejt dhe mund të mbarojë.

Ne mund të ndihmojmë me **kursimin e energjinë elektrike**. Kështu do të mbrojmë edhe mjedisin jetësor.



Mendoni dhe shpjegoni se si mund të kursejmë energjinë elektrike.



Bëni poster me këshilla për kursimin e energjisë elektrike.

# ENERGJIA-PËRSËRITJE



## RRETHONI

1. Çfarë është nxehtësia?  
a) energji    b) bimë    c) gur
2. Tostieri është burim i:  
a) dritës    b) nxehtësisë    c) punës
3. Çfarë na nevojitet për çdo gjë që bëjmë?  
a) nxehtësi    b) hije    c) energji

## PLOTËSONI

4. Temperaturën e matim me .
5. Objektet që nuk lëshojnë dritë janë , ato të cilave u mungon pjesërisht janë  dhe atyre që plotësisht e lëshojnë janë .
6. Rruga nëpër të cilën bartet energjia elektrike është .

## PËRGJIGJU

7. Si përdoret energjia nga Dielli nga ana e njeriut?

---

8. Pse është e rëndësishme për ne energjia e nxehtësisë?

---

9. Cilat lëndë djegëse e ndotin mjedisin? \_\_\_\_\_

---

10. Si do ta kursejmë energjinë elektrike gjatë gatimit dhe ftohjes?

---

---





SH

T

O

J

C

A




# SHTOJCA 1



Pritini modelin përgjatë vijave të plota.  
Palosni në vijat e ndërprera. Palosni si në  
figurë dhe e ngjitni. Modeli është gati  
për të vizatuar.



i






# SHTOJCA 2


A rectangular writing box with a blue border. It features a decorative border with a teal circle on the left, a red circle with a paw print on the right, and floral motifs at the bottom. The interior has four horizontal blue lines for writing.A rectangular writing box with a blue border. It features a decorative border with a teal circle on the left, a red circle with a paw print on the right, and floral motifs at the bottom. The interior has four horizontal blue lines for writing.A rectangular writing box with a blue border. It features a decorative border with a teal circle on the left, a red circle with a paw print on the right, and floral motifs at the bottom. The interior has four horizontal blue lines for writing.A rectangular writing box with a blue border. It features a decorative border with a teal circle on the left, a red circle with a paw print on the right, and floral motifs at the bottom. The interior has four horizontal blue lines for writing.A rectangular writing box with a blue border. It features a decorative border with a teal circle on the left, a red circle with a paw print on the right, and floral motifs at the bottom. The interior has four horizontal blue lines for writing.A rectangular writing box with a blue border. It features a decorative border with a teal circle on the left, a red circle with a paw print on the right, and floral motifs at the bottom. The interior has four horizontal blue lines for writing.A rectangular writing box with a blue border. It features a decorative border with a teal circle on the left, a red circle with a paw print on the right, and floral motifs at the bottom. The interior has four horizontal blue lines for writing.A rectangular writing box with a blue border. It features a decorative border with a teal circle on the left, a red circle with a paw print on the right, and floral motifs at the bottom. The interior has four horizontal blue lines for writing.

# SHTOJCA 3





# SHTOJCA 4









**SHTOJCA 5**





# SHTOJCA 6

## FLETORE HULUMTIMI

MBROJTJA E VENDBANIMEVE JETESORE

Data: \_\_\_\_\_



**PROBLEMI:**

**ANËTARËT E GRUPIT:**


**QENIET E GJALLA QË JETOJNË NË ATË  
VENDBANIM:**

**ÇKA VËREJMË:**



**MATERIALET QË I  
PËRDORËM:**

**IDEJA JONË PËR ZGJIDHJE TË PROBLEMIT:**





# ŠHTOJCA 7





# SHTOJCA 8

## PLANI PËR HULUMTIM

ÇKA DO TË NDODHË ME BIMËN NËSE NUK KA UJË?

PARASHIKO SE ÇKA DO TË NDODHË ME BIMËN NËSE NUK KA UJË? VIZATO!

LARTËSIA E BIMËS NË FILLIM TË HULUMTIMIT

LARTËSIA E BIMËS NË FUND TË HULUMTIMIT

	DITA E 1-RË	DITA E 5-TË	DITA E 10-TË
SHËNO ÇKA VËREJTE TE BIMA			

SHËNO DHE VIZATO SE ÇKA KUPTOVE NGA HULUMTIMI.

A ISHTE INTERESANT HULUMTIMI?

NGJYROS LETRËN NË  
TË GJELBËR- SHUMË INTERESANTE  
TË VERDHË- INTERESANTE  
TË KUQE- PAK INTERESANTE







# SHTOJCA 9

## PLANI PËR HULUMTIM

ÇKA DO TË NDODHË ME BIMËN NËSE NUK  
KA DRITË?

PARASHIKO  
SE ÇKA DO TË  
NDODHË ME BIMËN  
NËSE NUK KA DRITË?  
VIZATO!

LARTËSIA E  
BIMËS NË FILLIM  
TË HULUMTIMIT

LARTËSIA E  
BIMËS NË FUND  
TË HULUMTIMIT

SHËNO ÇKA VËREJTE TE BIMA	DITA E 1-RË	DITA E 5-TË	DITA E 10-TË

SHËNO DHE VIZATO  
SE ÇKA KUPTOVE  
NGA HULUMTIMI.

A ISHTE  
INTERESANT  
HULUMTIMI?

NGJYROS LETRËN NË:  
TË GJELBËR- SHUMË INTERESANTE  
TË VERDHË- INTERESANTE  
TË KUQE- PAK INTERESANTE





# SHTOJCA 10

## PLANI PËR HULUMTIM

ÇKA DO TË NDODHË ME BIMËN NËSE E VENDOSIM  
NË VEND TË FTOHTË (FRIGORIFER)?

PARASHIKO  
SE ÇKA DO TË NDODHË ME  
BIMËN NËSE E  
VENDOSIM NË VEND TË  
FTOHTË (FRIGORIFER)?  
VIZATO!

LARTËSIA E  
BIMËSNË FILLIM  
TË HULUMTIMIT

LARTËSIA E BIMËS  
NË FUND TË  
HULUMTIMIT


	DITA E 1-RË	DITA E 5-TË	DITA E 10-TË
SHËNO ÇKA VËREJTE TE BIMA			

SHËNO DHE VIZATO  
SE ÇKA KUPTOVE  
NGA HULUMTIMI.

A ISHTE  
INTERESANT  
HULUMTIMI?

NGJYROS LETRËN NË:  
TË GJELBËR- SHUMË INTERESANTE  
TË VERDHË- INTERESANTE  
TË KUQE- PAK INTERESANTE





# SHTOJCA 11








Përpiloni modelin si më poshtë:

1. Ngjyrose
2. Preje
3. Ngjite hënën në njërin skaj të shiritit.
4. Skajin tjetër të shiritit ngjite me tokën me një thumb (bëje me një të rritur).
5. Me ndihmën e modelit të krijuar, shpjego lëvizjen e Hënës rreth Diellit.





# ŠHTOJCA 12







# SHTOJCA 13



DIELLI



ERA



LËNDA  
DJEGËSE



UJI

